

VENDIM
Nr.405, datë 22.4.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE
TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË
LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “b” të pikës 1 shtohet emërtesa “Shërbimi i Provës”.

b) Në lidhjen nr.4, të përmendur në pikën 5, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

“b/1. Në kategorinë III-b, pas emërtesës “Kryetar i zyrës së përmbarimit” shtohet “Drejtor i zyrës vendore të Shërbimit të Provës”;

b/2. Në kategorinë IV-a, pas emërtesës “Përmbarues gjyqësor në zyrat e përmbarimit gjyqësor”, shtohet “Specialist në zyrën vendore të Shërbimit të Provës”.

2. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës të Shërbimit të Provës të përcaktohen sipas vendimit për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, që do të miratohen për institucionin e Shërbimit të Provës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha